

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI JURIDIK**

**Kandidatja:** Jehona Asllanaj

**Mentori:** Prof.Dr.Bedri Peci

**Tema:** “ Roli dhe rëndësia e gjykatave tatimore në ekonomitë e tregut dhe rasti i Kosovës”

**Abstrakti**

Duke pasur në konsideratë rëndësinë e tërë Sistemit Tatimor në Kosovë i cili përfshin format e tatimeve, aplikimi i të cilave ka për qëllim realizimin e politikave financiare dhe ekonomike, si dhe sfidën kryesore me të cilën po përballlet Kosova nga mungesa e një Gjykate Tatimore, andaj ky studim tenton të analizojë rëndësinë e formimit të Gjykatës Tatimore, duke marrë për bazë Gjykatat Tatimore ekzistuese në shtetet me ekonomi të zhvilluar të tregut.

Të hyrat publike, e veçanërisht buxhetet e shteteve të ndryshme përballen me vështirësitë sa i përket mbledhjes të tatimeve, në raste të shumta aplikohen edhe masa fiskale ndaj tatimpaguesve në përmbushjen e detyrimeve të tyre. Në kontestin e vështirësive për pagesën e tatimeve, vullnetit për ti paguar tatimet institucionet shtetërore në kuadër të mungesës së Gjykatës, këtë çështje e kanë rregulluar me ligjet aktuale si dhe përmes Gjykatës Themelore Divizioni Fiskal, e më pastaj me krijimin e Gjykatës Komerciale ku lëndët janë bartur në Divizionin Fiskal, i cili vepron tashmë në kuadër të kësaj Gjykate.

Në pjesën e parë të punimit, është bërë shqyrtimi i literaturës së autorëve të ndryshëm, nga libra e publikime shkencore. Nga literatura është arritur kuptimi i tatimeve, si janë të zhvilluara kontestet tatimore dhe rëndësia e marrëdhënieve juridiko tatimore. Literatura e shqyrtuar, na ka ndihmuar që të kryejmë me sukses hulumtimin për kuptimin dhe efektet e tatimeve.

Pjesa e dytë e punimit, përfshinë hulumtimin e realizuar, duke mbledhur të dhënat përmes një analize krahasuese me Gjykatat Tatimore e funksionimin e tyre në shtetet me ekonomi më të zhvilluar të tregut, siç është Gjykata e Amerikës, në Gjermani, Angli dhe në Itali.

Në fund, nga rezultatet e fituara është mundësuar që të nxirren përfundime dhe disa rekomandime për studiuesit e ardhshëm të kësaj fushe.

Fjalët kyçe: Gjykatat Tatimore, Kosova, Tatimpaguesit, Ekonomia e tregut.